



07Nr.362 datë 06.07.2022

*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim  
The Directorate for Urbanism and Planning*

## RAPORT - GJASHTE MUJORSHI I PARE I VITIT 2022



ME THEKS TE VEQANT ARRITJET E DUP PER MUAJT JANAR-QERSHOR  
**LEGALIZIM-HZK**

RAPORT QE FLET ME SHUME PERMES FOTOGRAFIVE

*KORRIK, 2022*

## **1. Përshkrim i shkurtër i Aktiviteteve për gjashte muajt e parë të vitit 2022**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2022 ka vazhduar me angazhime maksimal në realizimin e obligimeve dhe detyrave me të cilat ngarkohet në sektorët e saj. Ky gjashte mujor veçohet me një angazhim të madhe të stafit në mbylljen e lëndëve të bartura nga viti i kaluar, përmbylljen e procesit të legalizimit si dhe përmbylljen e procesit të shqyrtimit publik rreth HZK-së.

Gjashtëmujorshi i parë është karakterizuar me mbylljen e procesit të VSM-së për HZK-në si dhe mbylljen e procedurave të HZK-së për vendosje në shqyrtim publik.

Gjatë kësaj periudhe gjithashtu DUP në bashkëpunim me Ekipin Komunal për Planifikim dhe Këshillin e Eksperteve, përmes kompanisë së kontraktuar ka vazhduar përpunimin dhe plotësimin teknik të Hartës Zonale të Komunës si një ndër proceset më me rendësi për DUP-në e që është arrit që dokumenti në fund të muajit mars të pajiset me pëlqim nga MMPHI-ja, ne prill të aprovohet në Asamblenë Komunale për vendosje e tij në diskutim publik si dhe nga 29.04.2022 deri me 30.05.2022 te vendoset ne shqyrtim publik.

Sa i përket PRRU-ve (të pezulluara të cilat vazhdimisht janë cituar nëpër raportet paraprake) ende nuk kemi pranuar një përgjigjeje nga MMPHI-ja rreth lejimit apo mos lejimit të zbatimit të tyre.

Gjithashtu në këtë raport vlen të përmenden edhe projektet kapitale të cilat janë në menaxhim nga DUP-ja e që në këtë periudhë kohore janë bërë përgatitjet për inicimin e procedurave për projektet dhe zbatim: Hartimi dhe revidimi i projekteve, Shenjëzimi horizontal dhe vertikal si dhe Deponit ilegale.

Ashtu si në çdo fillim vit edhe në muajt e parë të 2022, DUP ka vazhduar të merret me shqyrtimin e kërkesave për trajtimin e objekteve pa leje. Ky proces ka filluar qysh nga korriku i 2019 duke vazhduar kështu në 2020, 2021 si dhe 2022 me një rritje të madhe të kërkesave. Kjo periudhë është karakterizuar me lëshimin e një numri të madh të certifikatave mbi legalizimin e objekteve.

Përpos punëve të lartcekura, stafi përgjegjës në DUP është marrë edhe me kryerjen e punëve tjera varësisht nga lloji i kërkesave të palëve, Komunës dhe Institucioneve jashtë saj.

Gjithashtu ky gjashte muaj karakterizohet me numrin e madhe të qytetarëve të cilët i janë drejtuar zyrave të DUP për tu informuar rreth lëndëve, çështjeve të caktuara e në veçanti sa i përket informatave rreth planeve zhvillimore dhënë veçanti gjatë procesit të shqyrtimit publik te HZK-së.

Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore janë pranuar **318** lëndë, ndërsa janë përcjellë **537** shkresa rreth lëndëve të pranuar si dhe të karakterit të ndryshëm. Në vazhdimësi janë mbajtur takime me qytetarë, organizata të ndryshme takime me institucione qendrore si dhe takime të ndryshme në nivel komunal. Një rendësi e veçantë i është kushtuar takimit me qytetar datë 05.05.2022 si dhe takimeve të vazhdueshme ditore të mbajtura gjatë shqyrtimit publik të HZK-së.

DUP vazhdon të bërë maksimumin që punët në drejtori të kryhen me intensitet të shtuar në mënyrë që zhvillimet në gjashtëmujorin e dytë të vazhdojnë pa ngecje eventuale dhe viti të mbyllet me një sukses pune edhe më të lartë nga viti paraprak.

**DUP gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2022 është marrë me shqyrtimin e kërkesave të ndryshme.**

Deri më tani kemi pranuar **318** kërkesa të ndryshme ku për lëndët që trajton zakonisht drejtoria janë pranuar **247** kërkesa ndërsa për legalizim të ndërtimeve janë pranuar **71** kërkesa. Çdo kërkesë është shqyrtuar në bazë të kapaciteteve njerëzore profesionale që i posedojmë në stafin e DUP.

***Kryesisht kemi pranuar kërkesa për:***

- a. Kushte Ndërtimore
- b. Leje Ndërtimore
- c. Leje rrënimi
- d. Legalizim të objekteve
- e. Shfrytëzim të Hapësirave Publike
- f. Vendosije të Sinjalizimeve rrugore
- g. Emërtim të rrugëve
- h. Pëlqime në parim rreth planifikimeve për investim privat
- i. Përshkrim të planeve zhvillimore dhe rregulluese
- j. Certifikim të objekteve të ndërtuara me leje ndërtimi
- k. Vërejtje rreth Draftit të HZK-së
- l. Dhe kërkesa të karakterit të ndryshëm.

***Janë përcjell gjithsejtë 533 shkresa të ndryshme, prej tyre 345 janë shkresa rreth kërkesave të ndryshme si dhe 188 janë rreth legalizimit:***

- a. Aktvendim mbi Kushte Ndërtimore
- b. Njoftime rreth Kushteve ndërtimore,
- c. Aktvendim mbi Leje Ndërtimore,
- d. Leje rrënimi
- e. Njoftime publike
- f. Certifikatë Legalizimi dhe përdorimi
- g. Vendim për përfshirje në listë të pritjes-për legalizim
- h. Vendim për përfundim të punimeve për lëndët e legalizimit
- i. Kërkesë për regjistrim në kadastrës rreth kërkesave të legalizimit
- j. Pëlqime për Shfrytëzim të Hapësirave Publike
- k. Pëlqime në Parim dhe të ndryshme
- l. Përshkrime të parcelave duka u bazuar në Plane Zhvillimore dhe Rregulluese
- m. Plotësim lënde rreth kërkesave të ndryshme,
- n. Raporte,
- o. Ftesa dhe kërkesa
- p. Refuzime të ndryshme,
- q. Njoftime për pagesa të ndryshme

***Punë tjera në DUP gjatë muajve Janar-Qershor 2022:***

- a. Përcjellja e procesit të hartimit të HZK-së.
  - b. Përcjellja e procesit të zbatimit të Planeve Zhvillimore, Rregulluese dhe atyre të Hollësishëm.
  - c. Inicimi i procedurave për projekte kapitale që janë nën kompetencën e DUP-së dhe drejtorive të tjera.
  - d. Raporte të ndryshme për Kryetarin, Drejtorinë e financave, Ministrinë përkatëse dhe auditorët.
  - e. Dalje në teren për lëndë të caktuara dhe verifikimi i kërkesave varësisht nga karakteri i tyre.
  - f. Inspektimi i objekteve të kategorive të II-ta siç e përcakton ligji për trajtimin e objekteve pa leje.
  - g. Vlerësime të ndryshme urbane dhe ndërtimore me kërkesë të palëve apo për nevoja të komunës.
  - h. Përcjellja e procesit dhe organizimi i aktiviteteve informuese me grupin punues për legalizimin e objekteve pa leje ne mbështetje nga USAID.
  - i. Raportim rreth procesit të legalizimit sipas kërkesës së USAID-it.
  - j. Raportim tremujor për Leje ndërtimore sipas kërkesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.
  - k. Barazime financiare rreth të hyrave për çdo muaj.
  - l. Përcjellja e sistemit të Intranetit si dhe paraqitja e lëndëve të mbyllura.
  - m. Futja e të dhënave në sistemin e Përformances Komunale.
  - n. Pjesëmarrje në trajnim të ndryshme.
- 
- Sa i përket lëndëve prej **247** kërkesave të pranuar në këtë gjashtëmujor, gjithsejtë janë mbyllur **130** kërkesa ndërsa janë në proces **117** kërkesa.
  - Sa i përket legalizimit janë pranuar **71** aplikime. Në këtë gjashtëmujor janë shqyrtuar **24** kërkesa ndërsa **47** janë në proces.
  - Sa i përket procesit të legalizimit gjithsejtë nga 2019 deri në fund të gjashtëmujor të parë të 2022 janë pranuar **440** kërkesa.

**Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje rrënimi:**

Sektori i urbanizmit është marrë kryesisht me shqyrtimin e kërkesave të tilla. Kërkesat janë shqyrtuar nga stafi profesional i drejtorisë dhe vendimet janë marrë duke u bazuar në Dokumentet e planifikimit, Ligjet në fuqi dhe Normat teknike të planifikimit hapësinor.

*Në tabele janë prezantuar kërkesat rreth Kushteve ndërtimore, Leje Ndërtimi dhe Rrënim për gjashtë muaj*

<b>Lloji i kërkesës</b>	<b>Totali i pranuar</b>	<b>Të aprovuara</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Në proces</b>
<b>Leje ndërtimi</b>	<b>08</b>	<b>5</b>	<b>1(+1pezullim)</b>	<b>1</b>
<b>Kushte ndërtimore</b>	<b>32</b>	<b>5+(1mbyllje me pranim+1njoftim rreth kerkeses)</b>	<b>16(+5pezullim)</b>	<b>4</b>
<b>Leje rrënimi</b>	<b>03</b>	<b>3</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Për të pasur një zhvillim më të madh sa i përket ndërtimeve në Komunë e që paraprakisht do të duhet të jenë të pajisur me dokumentacion përkatës edhe përkundër numrit të kufizuar të stafit që e posedojmë, ne si DUP në vazhdimësi kemi tentuar që lëndët e këtij sektori të kryhen me prioritet. Në raste specifike trajtimi i lëndëve ka hasur në pengesa sa i përket lëshimit të Kushteve ndërtimore dhe Lejeve të ndërtimit jashtë zonës urbane si rezultat i pengesave nga MMPHI-ja ku përmes vendimit mbi aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal 2021-2029 e ka ndaluar trajtimin e lëndëve të këtij karakteri jashtë zonave të mbuluara me plane urbane dhe rregulluese, e që në raste të tilla lëndët janë pezulluar përkohësisht deri në aprovim të Hartës Zonale të Komunës 2022-2030.

Hartimi i Hartës Zonale të Komunës dhe përmbyllja e saj si proces do të ndihmoj shumë në mbarëvajtje të punës në drejtori, si në cilësi, efikasitet dhe trajtim të duhur të çdo detyre. Për të lëshuar një Njoftim rreth Kushteve ndërtimore apo Leje ndërtimi dokument bazë të cilit i referohemi është ky dokument si dhe Planet Rregulluese. Dokumentet më me rendësi të lëshuara nga DUP vazhdojnë të publikohen në web faqen e komunës.

Për një mbarëvajtje të zhvillimeve në drejtori ne, në vazhdimësi kemi pasur takime dhe konsultime me të gjitha sektorët tjera që veprojnë në nivel komunal, me komunitat fqinje si dhe me nivelin qendror.

Vlen të ceket se sa i përket të hyrat buxhetore të planifikuara për vitin 2022 ka ngecje si pasojë e pengesave me vendim nga MMPHI-ja për trajtimin e lendeve për kushte dhe leje ndërtimi jashtë zonave të mbuluara me Plane rregulluese dhe urbane.

Besojmë që me aprovimin e HZK-së do të kemi një vull të madh të kërkesave për leje ndërtimi e që të hyrat nga to do ti kalojnë pritshmërinë sa i përket planifikimeve buxhetore.

<b><u>Të hyrat buxhetore në DUP (për gjashtë muaj) për vitet 2014-2022</u></b>									
<b>VITI</b>	<b><u>2014</u></b>	<b><u>2015</u></b>	<b><u>2016</u></b>	<b><u>2017</u></b>	<b><u>2018</u></b>	<b><u>2019</u></b>	<b><u>2020</u></b>	<b><u>2021</u></b>	<b><u>2022</u></b>
<b>Janar</b>	105.00	3,679.02	8,552.06	10,748.62	15.00	4,369.54	9,371.46	7,643.60	130.57
<b>Shkurt</b>	130.00	45.00	15,189.77	6,271.99	2,165.50	16,281.23	25,073.28	10,366.60	1170.83
<b>Mars</b>	712.24	15,022.30	2,086.90	9,639.07	65.00	6,427.55	5,230.15	6,722.40	774.11
<b>Prill</b>	9,983.67	8,301.75	5,947.79	15,529.17	1,718.19	65.00	1,606.00	9,467.84	11,374.69
<b>Maj</b>	1,522.14	2,470.76	3,684.92	4,794.44	7,173.19	12,812.47	2,349.36	1,166.67	7,030.97
<b>Qersh.</b>	9,897.56	8,729.56	585.12	7,359.07	2,475.87	3,385.59	49,673.60	11,065.72	61,829.22
	<b>22,350.61</b>	<b>38,248.39</b>	<b>36,046.26</b>	<b>54,342.36</b>	<b>13,612.75</b>	<b>43,341.38</b>	<b>93,303.85</b>	<b>46,432.83</b>	<b>82,295.39</b>

**Të hyrat Buxhetore nga Legalizimi i ndërtimeve të ndërtuara pa Leje ndërtimi**

	MUAJI	VITI 2019		VITI 2020		VITI 2021		VITI 2022	
		Nr.fat.	Vlera €	Nr.fat.	Vlera €	Nr.fat.	Vlera €	Nr.fat.	Vlera €
1	Janar	/	/	5	1368.62	/	/	1	24.57
2	Shkurt	/	/	5	1018.1	11	10,116.6	1	322
3	Mars	/	/	10	2126.81	2	3382	3	379.11
4	Prill	/	/	3	1606	2	481.12	5	1,562.61
5	Maj	/	/	5	1542.69	5	1151.68	9	2,454.78
6	Qershor	/	/	10	16,227.79	1	527.75	3	11,520.36
		<b>0</b>	<b>0</b>	<b>38</b>	<b>23,890.01</b>	<b>21</b>	<b>15,659.15</b>	<b>22</b>	<b>16,589.62</b>

Ty hyrat buxhetore nga Lejet ndërtimore për gjashtë muajt e parë të 2022 janë **65,705.77€**

Ty hyrat buxhetore nga Legalizimi i ndërtimeve pa leje për vitin 2022 janë **16,589.62€**

**2.0 Aktivitete kryesore me të cilat është marr DUP gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2022 janë:**

**2.1 Zbatimi dhe monitorimi i PZHK-së**

**2.2 Vazhdimi i procedurave rreth Hartës Zonale të Komunës**

**2.3 Pajisja me pëlqim rreth Raportit për VSM të HZK-së**

**2.4 Vazhdimi i Procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje**

**2.1 Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal 2021-2029 :**

PZhK është një dokument multisektorial i cili përcakton kahet e zhvillimit të komunës për 8 vitet e ardhshme. Ky dokument ashtu si është raportuar edhe në raportet tjera ka përfunduar vitin e kaluar ku është aprovuar me datë 29.10.2021 nga asambleja komunale pas një procesi të gjatë planifikues. Aprovimi i tij ka një rendësi të veçantë pasi që u krijua mundësia që HZK-ja pas marrjes së pëlqimit për VSM me 26.01.2022, me datë 30.01.2022 të procedohet për miratim në MMPHI për tu pajisur me pëlqim për tu vendosur në diskutim publik, te aprovohet nga asambleja komunale për vendosje në shqyrtim publik si dhe të përmbyllet procesi i shqyrtimit publik.

**Gjendja aktuale** -Vendimi mbi aprovimin nga Asambleja Komunale të PZhK-së 2021-2029 obligon komunën për implementimin e tij. Tani është në zbatim nga DUP-ja por edhe nga të gjitha sektorët tjera që veprojnë në nivel komunal.


**Hapat e mëtejme** - Komuna e ka obligim që të merret me zbatimin e PZHK-së. Procesi i zbatimit do të monitorohet nga DUP-ja. Në përputhje me Ligjin e Planifikimit rreth zbatimit të tij nga ana e komunës në çdo fund vit DUP do të raportoj para autoritetit aprovues të tij.

**Pritjet** - Aprovimi i këtij plani hap rrugë për një zhvillim të qëndrueshëm sektorial ndër komunal për 8 vitet e ardhshme. Zbatimi i tij dhe hartimi i planeve tjera zhvillimore që rrjedhin pas PZHK-së gradualisht Komunën e vë në një sistem zhvillimor të planifikuar mirë.

## **2.2 Hartimi i Hartës Zonale të Komunës**

Rreth zhvillimeve në procesin e HZK-së është raportuar në raportin vjetor të lëshuar nga DUP. Në vazhdim të këtij raporti sa i përket HZK-së do të përshkruhen vetëm rrjedha e procesit që është zhvilluar në gjashtë muajt e fundit. Siç u cek edhe me lartë aprovimi i PZHK-së në nëntor të 2021 hapi rrugë për procedim të HZK-së për pëlqim në MMPHI. Edhe përkundër faktit se për VSM të HZK-së është aplikuar qysh në nëntor të vitit të kaluar në MMPHI, ky dokument është aprovuar tek në fund të muajit janar 26.01.2022. Menjëherë pas marrjes së VSM-së DUP me datë 31.01.2022 ka aplikuar në MMPHI për marrjen e pëlqimit për vendosjen e HZK-së në diskutim publik. Të njëjtën ditë stafi përgjegjës i projektit ka mbajtur takim konsultativ me MMPHI-në ku është kërkuar nga ana e tyre që ti japin prioritet trajtimit të këtij dokumenti.

Duke iu referuar komenteve dhe vërejtjeve të dhëna nga MMPH në dokumentin e HZK-së kompania e kontraktuar është marr me plotësimin e tyre dhe përmirësimin në përputhje me kërkesat e dala nga komisioni për vlerësim. Me datë 24.03.2022 stafi nga kompania projektuese ka mbajtur takim online ku janë diskutuar të gjitha pikat e përfshira në vlerësim dhe mënyra e trajtimit të tyre.



Me ftesë të MMPHI-së kompania e kontraktuar në bashkëpunim me Komunën e Suharekës kanë bërë prezantimin e dokumentit para përfaqësuesve të Ministrisë me datë 04.03.2022. Në këtë takim të pranishmit janë njoftuar me përmbajtjen e materialit si dhe me mënyrën e rrjedhës së procesit në nivel komunal deri në formësimin e dokumentit. Nga ana e të pranishmeve u komplimentua puna e komunës për mënyrën e procedimit të dokumentit, formën e organizimit të takimeve, publikimin e materialeve, mënyrën e raportimit nga drejtoria si dhe mënyrën e trajtimit të kërkesave të qytetarëve nga EKP dhe KE.



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë  
Raport Pune për Gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022



Me ftesë të MMPHI-së përsëri DUP me datë 18.03.2022 së bashku me kompaninë ka mbajtur takim pune ku janë diskutuar edhe disa plotësime në dokument. Dokumenti final i përmirësuar sipas kërkesave të MMPHI-së është dorëzuar për pëlqim me datë 21.03.2022 ndërsa me 22.03.2022 DUP është pajisur me pëlqim për vendosjen e dokumentit në diskutim publik.

Gjatë periudhës kohore nga aplikimi për pëlqim në MMPHI deri në pajisjen me dokument autoriteti përgjegjës në nivel të drejtorisë është marr me kontroll teknike të dokumentit për të cilin edhe është lëshuar raport. Në mënyrë që komentet e dhëna në këtë raport të mos kenë karakter të një anshëm është organizuar takim me Këshillin e Eksperteve për Planifikim të HZK si dhe me Ekipin komunal ku është diskutuar detalisht raporti i drejtorisë. Nga ky takim i mbajtur me datë 25.03.2022 unanimisht u përkrahen propozimet e drejtorisë ku dhe përmes rekomandimit u është kërkuar kompanisë hartuese të projektit kompletimin e dokumentit para daljes në diskutim publik.



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E SUHAREKËS THE MUNICIPALITY OF SUHAREKË	
<b>Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim</b> The Department of Urban and Planning	
<b>DATA:</b>	07 Nr. 112 datë 25.03.2022
<b>PËRTO:</b>	INSI - Sh.k. Prokuror - Jemal Bajraktari përfaqësues
<b>NGAFRIMI:</b>	Koordinator i Projektit Nikollë LOSHI DURNISHI
<b>PËRMES:</b>	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
<b>CC:</b>	Kryetari e Komunitet e Rajit Suharekë Drejtori të Departamentit të Sëpatë Sëpatë Membërit e Prokurorisë e Departamentit të Sëpatë Sëpatë
<b>TEMA:</b>	Raport për tërësitë komerciale dhe HZK-se për planin me 20.01.22 Agjencitë nga KE dhe EKP
<b>Autoriteti kompetent:</b>	Komuna e Suharekës
<b>Tirimi i kërkesës:</b>	Hartimi dhe Harmonizimi i Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor-Hartë Zonë e Komunitetit
<b>Operatori qëmbartës:</b>	INSIT "INSI" nga Prishtina me përfaqësues Jemal Bajraktari
<b>Nr i punësuarit:</b>	624-19-305-323 624-19-006-433
<b>Vlera e kontraktit:</b>	82.000.000

Nr.	Familja dhe Mbiemri	Poste në krah të projektit	Niveli i krahimit
<b>Ekipi Komunal për Planifikim të HZK-se</b>			
1.	Vitet Kuj	Udhëheqës i EKP-se	
2.	Dorian Berisha	Membër i HZK-se	
3.	Nedžad Lahi Durnishi	Koordinator i HZK-se	
4.	Nedžad Lahi Durnishi	Anëtar i EKP	
5.	Selma Kadri	Anëtar i EKP	
6.	Shqipëri Kadri	Anëtar i EKP	
7.	Konstantin Durnishi	Anëtar i EKP	
8.	Adnan Kadri	Anëtar i EKP	
9.	Agim Bërdibashi	Anëtar i EKP	
10.	Naimi Ali	Anëtar i EKP	
11.	Shqipëri Kadri	Anëtar i EKP	
12.	Riza Durnishi	Anëtar i EKP	
13.	Adnan Kadri	Anëtar i EKP	
14.	Adnan Kadri	Anëtar i EKP	
<b>Këshilli i Ekspertëve për Planifikim Hapësinor</b>			
15.	Edmond Durnishi	Kryetari i KE	
16.	Ena Basha	Anëtar i KE	
17.	Riza Durnishi	Anëtar i KE	
18.	Shqipëri Kadri	Anëtar i KE	
19.	Mehmet Kadri	Anëtar i KE	
20.	Edmond Durnishi	Anëtar i KE	

Nr. R	Emri dhe Mbiemri	Nr. Telefoni	Email Adresi	Niveli i krahimit
1	DURISHI EMIL DURNISHI	049 282 250	durnishi@insit.com	Insit
2	Agjencitë DURNISHI	049 461 033	insit@insit.com	Insit
3	Agjencitë DURNISHI	049 461 033	insit@insit.com	Insit
4	DURNISHI EMIL	049 461 033	insit@insit.com	Insit
5	DURNISHI EMIL	049 461 033	insit@insit.com	Insit
6	DURNISHI EMIL	049 461 033	insit@insit.com	Insit
7	DURNISHI EMIL	049 461 033	insit@insit.com	Insit
8	DURNISHI EMIL	049 461 033	insit@insit.com	Insit
9	DURNISHI EMIL	049 461 033	insit@insit.com	Insit
10	DURNISHI EMIL	049 461 033	insit@insit.com	Insit

11	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
12	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
13	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
14	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
15	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
16	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
17	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
18	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
19	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
20	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
21	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
22	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
23	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
24	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
25	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
26	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit
27	AGJENCITË	049 461 033	insit@insit.com	Insit


Pa marrjes së pëlqimit nga MMPHI-ja materiali menjëherë është përcjellë për KPF për procedim të mëtejshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Me 30.03.2022 Asambleja komunale ka marr vendim për vendosjen e dokumentit në diskutim publik.





### **Shqyrtimi Publik i HZK-se**

Dokumenti duke i respektuar të gjitha dispozitat ligjore si mënyrat e informimit, prezantimit, diskutimeve është vendosur në Shqyrtim publik nga data 29.04.2022 deri me datë 30.05.2022. Materiali është ekspozuar në hollin e komunës në katin e dytë pran zyrave për urbanizëm në objektin e vjetër të komunës. Gjithashtu materiali është vendosur edhe në web faqen e komunës ku çdo i interesuar ka mundësi të ketë qasje të lehtë në të.



Gjatë kësaj periudhe kohore një mujore ka qenë një numër i madh i qytetarëve të cilët janë interesuar për përmbajtjen e planifikuar me HZK në parcelat e tyre ku dhe një pjesë e tyre kanë bërë edhe kërkesa. Informimi është bërë përmes hartave në korridore si dhe përmes prezantimeve në zyrat e drejtorisë.

Një element i veçantë që e karakterizon këtë proces është se Komuna e jonë përmes detyrës projektuese ka kërkuar nga kompania që përpos hartave të përgjithshme sipas ligjit, udhëzimeve dhe normave të planifikimit që duhet të hartohen, nga ana e jonë është kërkuar që çdo vendbanim të ketë nga një hartë të veçantë të shfrytëzimit të planifikuar të tokës. Këto harta kanë qenë pjesë e shqyrtimit publik. Kopjet e tyre do të shpërndahen në kryesit e vendbanimeve ku do ju shërbej për nevoja të informimit me detaj dhe zbatimit më të lehtë të tyre në të ardhmen.

*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë  
Raport Pune për Gjashëmujorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022*

Rreth të dhënave me detale të shqyrtimit publik të HZK-së do të jepet informim përmes raportit përfundimtarë si dhe përmes raporteve të veçanta që lëshohen rreth HZK-së.



REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË  
SKUPSTINA OPŠTINE SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**Komuna e Suharekës  
Zyra për Informim  
07Nr.156  
Me datë: 22.04.2022**

Bazuar në Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174, UA Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, dhe UA nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, Komuna e Suharekës ju fton në:

# SHQYRTIM PUBLIK


22.04.2022

Për: **Propozim Harta Zonale e Komunës 2022-2030**  
Datë: **29.04.2022 deri më 29.05.2022**  
Vendi: **Objekti i Komunës së Suharekës**  
*Prezantimi i dokumentit nga Komuna e Suharekës do të mbahet*  
Datë: **05.05.2022 (E Enjte)**  
Ora: **11:00**  
Vendi: **Palestra sportive "13 Qershori"- Suharekë**





REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA		PRILAVENJE / RECEIVED	
NO. / NO.	REDAKTOVA / REVISIJA / REVISION	PRILAVENJE / RECEIVED	TRIMET / VOUCHER / VALUE
Orig. List	Reviz. / Rev. / Revision	Prilav. / Appr. / Approved	Vouch. / Value
01	016	24476	2

Dokumentin mund ta gjeni në linkun : <https://kk.rks-gov.net/suhareke/urbanizem/>  
Shqyrtimi publik do të zgjat **30 ditë**, nga data 29.04.2022 – 29.05.2022, ku të gjithë të interesuarit mund të japin komente, vërejtje apo sugjerime, të cilat do të shqyrtohen me profesionalizëm dhe korrektësi të plotë. Takime konsultative me qytetarë gjatë shqyrtimit publik do të ketë çdo ditë pune pranë zyrave të DUP-së. Komentet mund të dorëzohen zyrtarisht në mënyrë fizike në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim, apo përmes formës elektronike në email [urbanizemisuhareke@rks-gov.net](mailto:urbanizemisuhareke@rks-gov.net) dhe [visa@rks-gov.net](mailto:visa@rks-gov.net)




**Kryetari i Komunës:  
Bali MUHARREMAJ**








*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë  
Raport Pune për Gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022*







*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë  
Raport Pune për Gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022*




*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë  
Raport Pune për Gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022*



*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë  
Raport Pune për Gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022*





## Takimi Publik rreth HZK-se


Vlen të ceket se gjatë tërë procesit të hartimit të planit janë mbajtur 42 takime ku **26 takime zyrtare** (direkt dhe online) si dhe **16 takime me qytetare** si dhe janë lëshuar gjithsejtë **34 Raporte** ku është përshkruar procesi i punës dhe arritjet në faza të caktuara.

Pas hapjes së diskutimit publik për Hartën Zonale të Komunës së Suharekës, duke i respektuar dispozitat ligjore në fuqi drejtorja ka organizuar diskutim publik ku është prezantuar Drafti i HZK-se. Takimi është mbajtur në Palestrën sportive 13 Qershori në Suharekë. Pjesëmarrja qytetare ka qenë shumë e madhe. Nuk kanë munguar as mysafir nga komunat fqinje, ministria si dhe organizata të ndryshme. Nga ana e komunës kanë qenë të pranishëm të gjithë stafi udhëheqës i komunës si dhe i DUP-së.

Para të pranishmeve nga ana e kompanisë është bërë prezantimi i hartave në mënyrë përmbljedhëse. Në këtë takim nuk ka munguar interesimi i të pranishmeve për tu informuar me detalisht rreth përmbajtjes së planit si dhe komentet pozitive rreth tij.


# Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë

## Raport Pune për Gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022





*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë  
Raport Pune për Gjashtëmuajorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022*



*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë  
Raport Pune për Gjashëmujorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022*



*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë  
Raport Pune për Gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022*



*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë  
Raport Pune për Gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022*



## Takim me EKP dhe KE për te diskutuar per raporti e shqyrtimit

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, pas përfundimit të diskutimit dhe shqyrtimit publik me qytetar i cili është mbajtur duke filluar nga data 29.04.2022 deri me datë 30.05.2022 rreth Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030, ka hartuar Draft Raportin e shqyrtimit publik 07Nr.259 datë 15.06.2022 si dhe draftraportin përmbledhës të kërkesave nëpër lagje 07 Nr.260 datë 15.06.2022.


Ky raport si dhe ai përmbledhës i është referuar kërkesave zyrtare të pranuar përmes zyrës së pranimit (në DUP, zyrën e kryetarit të komunës, kryesuesit të kuvendit), kërkesave direkte në DUP (përmes aplikimit me formular direkt të regjistruara në fletoren e ankesave) si dhe kërkesave të ardhura përmes emailave zyrtar.


- Numri i tërësishëm i kërkesave të pranuar nga data 29.04.2022 deri me 30.05.2022 ka qenë 139 kërkesa.
- Pjesëmarrës në prezantim publik si dhe palë të interesuar për të marr skjarimet e duhura në zyrat e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim kanë qenë mbi 350 persona.

Ka pas raste kur apikuesit për të njëjtën kërkesë kanë aplikuar në më shumë së një formë. Në llogari janë marr totali i të gjitha kërkesave.

Pas hartimit të raportit DUP mbrena afatit ligjore ka organizuar takim pune tre ditore me datë 27, 28, 29.06.2022 me Ekipin Komunal për planifikim të HZK-së si dhe Këshillin e Eksperteve.

Gjatë këtij takimi detalisht është shqyrtuar çdo kërkesë, për të cilën edhe është dhënë vlerësimi nga ana e grupit punues rreth aprovimit të kërkesës apo refuzimit. Vlerësimi i kërkesave sa i përket ngritjeve të zonimeve kryesisht është bërë me sistemin piramide duke ruajtur etazhitetin më të ultë të zhvillimeve të planifikuara në periferi si dhe atë më të lartë në qendër, me një shpërndarje të njëtrajtshme drejt rrugëve magjistrale dhe regjionale. Një ndihmesë të madhe gjatë vlerësimit ka dhënë edhe raporti përmbledhës ku kërkesat janë shqyrtuar në grup për lagje të caktuar. Në këtë mënyrë vlerësimi i kërkesave është bërë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme për të gjithë.





**Gjendja aktuale-**Dokumenti nga asambleja komunale është miratuar në funde të marsit për tu vendos në diskutim publik. Ndërkohë Këshilli i Eksperteve në bashkëpunim me Ekipin komunal për Planifikim kanë shqyrtuar draftin rreth plotësimeve teknike duke iu referuar raportit të drejtorisë. Me aprovim të asamblesë komunale dokumenti është vendosur në shqyrtim publik nga 29.04.2022 deri me datë 30.05.2022. Pas përmbylljes se diskutimit publik është hartuar raporti përmbledhës i drejtorisë ku janë përfshirë të gjitha komentet dhe vërejtjet e qytetarëve të ardhura në formë elektronike, zyrtare si dhe vërejtjeve të dhëna në zyrat e drejtorisë përmes fletores së komenteve.

**Hapat e mëtejme-** Pas mbajtjes së takimit me Këshillin e Eksperteve dhe Ekipin Komunal për Planifikim ku do të diskutohet në detale raporti përmbledhës me komentet dhe vërejtjet e qytetarëve, DUP do ta publikoj raportin në web faqen e komunës. Në këtë raport të shqyrtimit publik do të përshkruhen të gjitha vërejtjet dhe komentet si dhe vlerësimi i grupit punues rreth aprovimit apo mos aprovimit të tyre.

**Pritjet-**Në bazë të rrjedhës së procesit pritet që ky dokument të pajiset me raportin e shqyrtimit publik në javën e parë të korrikit. Më pas do të procedohet për aprovim në MMPHI si dhe me pas në Asamblenë Komunale.

## **2.2 Procesi i Legalizimit të ndërtimeve pa leje ndërtimore**

DUP vazhdon ti kushtoj një rendësi të veçantë procesit të legalizimit duke i angazhuar me lëndë (shitesë) zyrtarët e drejtorisë. Një kontribut të veçantë për mbarëvajtje të procesit vazhdon ta jep edhe Drejtoria për Çështje Pronësore, Juridike dhe Kadaster e cila në çdo kohë është e gatshme ta shqyrtoj këtë kategori të lëndëve. Procesi vazhdimisht monitorohet nga përfaqësues të MMPHI-së si dhe nga USAID-i.

Edhe këtë vit vazhdon të kemi një përkrahje të madhe nga USAIDI në mbarëvajtje të procesit. DUP po e bënë maksimumin për sensibilizim të opinionit e cila po ndikonnë rritjen e aplikimeve për legalizim të ndërtimeve të ndërtuara pa leje ndërtimore.

*-Sipas përmbledhjes së të dhënave në protokollin e Drejtorisë gjendja aktuale rreth procesit të legalizimit është me sa vijon:*

Nga fillimi i procesit të legalizimit deri në fund të gjashtë mujorshit të parë të vitit 2022 janë pranuar **440** kërkesa për legalizim të ndërtimeve pa leje, ku janë certifikuar-legalizuar **221** objekte si dhe janë përfshirë në listë të pritjes **140** objekte, ndërsa kërkesat tjera janë në proces të trajtimit apo janë mbyllur. Nëse i referohemi vetëm gjashtë mujorshit të vitit 2022 janë pranuar gjithsejtë **71** kërkesa, ndërsa janë lëshuar **188** shkresa. Shkresat e lëshuara janë: certifikata legalizimi **50**, vendime për përfundim të punimeve **0**, të përfshira në listën e pritjes **49**, kërkesa për regjistrim në kadastër **26**, njoftime për pagesë **23**, plotësim lënde **35** si dhe tërheqje nga procedura **3**.

Me 20.01.2022 është mbajtur takimi i radhës për këtë vit rreth procesit të Legalizimeve të ndërtimeve të ndërtuara pa leje ndërtimore me USAID-in dhe Përfaqësueses të MMPHI-së. Në këto takime kryesisht është diskutuar rreth zhvillimit të procesit për legalizimin e ndërtimeve pa leje si dhe hapat që do të merren në këtë vit deri në mbyllje të procesit. Vlen të ceket se si rezultat i arritjeve më të mira të treguara nga DUP në procesin e legalizimit, vitin e kalua Komuna e Suharekës është përzgjedhur në mesin e dhjetë komunave më të mira në vend, për mbështetje nga programi i USAID-it për Qeverisje Ekonomike në Kosovë.



**Me 06.06.2022 është mbajtur aktivitet Legalizo Ndërtimin-**Aktiviteti për informimin e drejtpërdrejt të qytetarëve për procedurat e aplikimit dhe përfitimet nga procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje ka vazhduar në Komunën e Suharekës. Janë shpërndarë materialet informuese në pika të caktuara të qytetit nga data 6 deri me datë 10 qershor.





*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim-Komuna Suharekë  
Raport Pune për Gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) për Vitin 2022*

Me 07.06.2022 nga ana e USAID-ite është organizuar Punëtori për Legalizimin e ndërtimeve pa leje. Në këtë punëtori kanë qene te pranishëm 3 zyrtar dhe dy drejtor te komunës sonë. Nga ana e komunave tjera si dhe komunës është raportuar rreth te arriturave te deritanishme ne këtë proces. Nga te pranishmit është vlerësuar larte puna e Komunës se Suharekës ku u cilësuar një nder komunat shembull për trajtimin e lëndëve të LEGALIZIMIT ne çdo aspekt. Pos tjerash u kërkua qe te vazhdohet me dhenje prioritete te lendeve te legalizimit duke pas parasysh afatin e fundit për aplikim i cili është deri me 4 shtator 2022.



**Gjendja aktuale-**Dita ditës numri i kërkesave rreth legalizimeve të ndërtimeve pa leje po rriten. Staf i DUP-së vazhdon të bënë të pamundurën që deri në shtator të këtij viti 2022 të gjitha kërkesat e parashtruara për legalizim të procedohen.

**Hapat e mëtejme-**Meqenëse Komuna e Suharekës ka marr mbështetje nga programi i USAID-it ashtu si në vitin 2021 edhe në vitin 2022 vazhdon të bahet maksimumi për informim të gjerë të opinionit rreth këtij procesi. Në kuadër të fushatës për sensibilizim të opinionit janë bërë njoftimet publike të cilat vazhdojnë edhe më tej të shpërndahen në qytet.

**Pritjet-**Deri në mbyllje të procesit (duke i pas parasysh afatet kohore të definuara me ligj rreth legalizimit) presim që numri i aplikimeve të shtohet. Gjithashtu besojmë që kjo do të ndikoj edhe në rritjen e numrit të aplikimeve për leje ndërtimi. Vetëm me një zhvillim të planifikuar mirë, të qëndrueshëm dhe të mbikëqyrur nga organet kompetente do të mund të krahasohemi me qytetet tjera evropiane.

### **3 Punë të përgjithshme në bashkëpunim me Drejtoritë dhe Institucione tjera**

1. Hartimi i HZK-së në bashkëpunim me EKP, KE, Stafin e urbanizmit, Ndërmarrjet Publike dhe Private, kryesi të vendbanimeve dhe lagjeve të qytetit, etj.
2. Inicimi i procedurave për projekte kapitale të DUP.
3. Koordinim dhe bashkëpunim me të gjitha Drejtoritë për realizim sa më të mirë të Projekteve me rëndësi për Komunën.
4. Pjesëmarrje në shumë komisione të ndryshme.
5. Dorëzim të raporteve të ndryshme varësisht nga kërkesat.
6. Pjesëmarrje e stafit në trajnime të shumta me karakter të ndryshëm pune .

### **4 Përmbyllje**

Gjashte muajt e parë i vitit 2022 për DUP kanë qenë me angazhim të shtuar në përmbylljen e lëndëve të bartura nga viti paraprak, përmbylljen e procesit planifikues të HZK-së, hartimin e raporteve, programeve, etj. Në përgjithësi puna vazhdon të kryhet mirë edhe përkundër numrit të kufizuar të stafit. Këtë periudhë, puna më e madhe është përqendruar në kompletimin e draftit të HZK-së duke përfshirë rekomandimet e MMPHI-së dhe procedimit sa më të shpejt të tij për diskutim publik në përputhje me dispozitat ligjor në fuqi dhe Planin Zhvillimor Komunal 2019-2029.

Nga DUP gjithashtu prioritet ka pasur edhe Pajisjes me pëlqim nga MMPHI-ja për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Hartën Zonale të Komunës, përmbylljen e procesit të shqyrtimit publik të HZK-së si dhe shqyrtimi i kërkesave të qytetareve e sidomos të Kushteve, Lejeve ndërtimore, Legalizimit të objekteve, inicimin e procedurave për projekte kapitale etj.

#### **Vlen të ceket se:**

- Në nivel të drejtorisë vazhdon të rritet transparenca e punës.
- Vazhdojnë të trajtohen me prioritet i lëndët varësisht nga kategoria e tyre.
- Numri i takimeve me qytetarë vazhdon të rritet çdo ditë.
- Është përmirësuar komunikimi me nivelin qendror në veçanti sa i përket MMPHI -së.
- Edhe përkundër mbingarkesës në punë vazhdon angazhimi i zyrtarëve në arritjen e objektivave të DUP.

**Sfidë:** *Sfidat pothuajse janë të njëjta me ato të specifikuar në raportin paraprak të DUP-së, ku vlen të cekën disa prej tyre:*

- Mungesa e zyrës së planifikimit dhe stafit të nevojshëm dhe profesional për të.
- Mos funksionimi i data bazës komunale ne softwerin qendror apo lokal për lexim të planeve dhe mos aktivizimi i licencave të GIS-it në disa kompjuter.
- Hapësirat e ngushta të punës dhe mungesa e një salle për shpalesje të planeve, për shqyrtime publike apo mbajtje të takimeve konsultuese me qytetar.
- Mos furnizimi me vite me letër, ngjyrë si dhe mos funksionalizimi i aparaturës për shtypje të hartave.
- Zgjatja e procesit të hartimit të HZK-së si pasoj e vonesave në aprovim të PZHK-së.
- Ndikimi i MMPHI-së në mos përmbylljen në fazën finale të disa projekteve të PRrH.
- Ngarkesat me punë shtesë në drejtori, mungesa e stafit të mjaftueshëm për përballim të proceseve të caktuara si atyre te planifikimit, legalizimit dhe nevoja e punës jashtë orarit të punës.
- Siguria jo e mjaftueshme në vendin e punës si rezultat i qasjeve direkt të palëve me zyrtaret.

Me përkushtim të madhe është punuar në këta gjashte mujor sa i përket proceseve të planifikimit në drejtori, ku këtë gjashtë muaj është arrit të merret pëlqimi për VSM të HZK-së, Pëlqimi nga MMPHI-ja dhe Asambleja komunale për vendosjen e HZK-së në diskutim publik si dhe përmbyllja e procesit të shqyrtimit publik të HZK-së. Në bazë të rrjedhës se deritanishme të punëve në këtë fushë besojmë që procedimi për aprovim i HZK-së do të bëhet së shpejti.

**Me respekt,** I dorëzohet: *Kryetarit të Komunës, Dosjes së Drejtorisë.*

SH.S.U

Nexhmije LOSHI DURMISHI

DREJTORI I DREJTORISE:

Visar KUQI